



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

**Për institucionalizimin e marrëdhënieve ndërmjet institucionit të Avokatit të Popullit dhe Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH)
Tiranë 3 Prill 2012**

Me qëllim që të realizojnë një veprimtari të përbashkët në respektimin, garantimin, forcimin dhe avancimin e mbrojtjes social-ekonomike dhe shoqërore të punëtorë, të papunëve, pensionistëve, grave, të rinjve, emigrantëve, invalidëve, etj. si dhe për të realizuar qëllimin dhe misionin sindikalist për të hartuar, udhëhequr dhe mbrojtur politikat e lëvizjes sindikale në vend, posacërisht në fushën e marrëdhënieve të punës, të pagave, të pensioneve, të përmirësimit të vazhdueshëm të kushteve të punës dhe të jetesës, sigurisë, etj. në Shqipëri; që të rrisin bashkëpunimin në drejtim të forcimit të zbatimit të legjislacionit, politikave të reja në fushën e, rritjes së cilësinë e shërbimeve, për të ndaluar e parandaluar rastet e veprimtarisë arbitrare nga organet e administratës publike, si dhe për të kërkuar ndërhyrjen pozitive të shtetit sa herë që paraqitet nevoja për ndalimin e dhunës, diskriminimit apo paragjykit, lidhet kjo marrëveshje, midis institucioneve:

1. **Avokati i Popullit, z. Igli Totozani**, me seli në Blv. "Zhan D'Ark", Nr.2, Tiranë. dhe
2. **Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë**. E njohur si Person Juridik, me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, Nr. 6/1, datë 03.09.1991, dhe e regjistruar në përputhje me ligjin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga Presidenti i saj Z. Kol Nikollaj, me seli në Sheshin "Garibali", Nr. 3, Kombinat, Tiranë.

Më poshtë referohen palët:

Objekti i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka për qëllim, institucionalizimin e bashkëpunimit të institucionit të Avokatit të Popullit me Konfederatën e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH), në kuadrin e punës së përbashkët dhe garantimit të realizimit të misioneve të përbashkëta vëzhguese në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të sindikalistëve, zhvillimit të politikave dhe ligjeve në favor të lëvizjes sindikaliste, si një lëvizje pluraliste, përfaqësuese dhe demokratike, luftës për eliminimin e diskriminimit për shkak të moshës, statusit, gjinisë, fesë, si dhe për avancimin e të drejtave të punëtorëve në Shqipëri, përfshirë ndër të tjera edhe avancimin e barazisë gjinore dhe pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, të minoriteteve dhe të të drejtave të njeriut në përgjithësi.

Fusha e zbatimit

Marrëveshja do të zbatohet midis palëve të lartpërmendura, në fushën e kësaj marrëveshje për të përmbushur objektin e saj.

Kjo marrëveshje do të konsistojë në:

- Ndërmarrjen e nismave të përbashkëta për propozime në kuadër të përmirësimit dhe ndryshimit të legjislacionit të punës, të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të asistencës sociale, të barazisë gjinore kundër diskriminimit, etj. në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në zbatim të Konventave të ILO-s, instrumentave koumitare të BE-së, si dhe të akteve të Këshillit të Europës.
- Referimin e rasteve konkrete, sipas nevojave të ankuesit/es, përfshirë edhe referimin e rasteve të ndërsjelltë midis Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) dhe institucionit të Avokatit të Popullit.
- Marrjen e iniciativave të përbashkëta për adresimin, referimin dhe zgjidhjen e rasteve konkrete, pranë organeve kompetente e gjykatave kombëtare, gjykatës Kushtetuese, si dhe organeve përkatëse ndërkombëtare.
- Angazhimin e Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) për të informuar Avokatin e Popullit për çështjet dhe problematikat, si dhe përgjithësimet e dala nga raportet monitoruese, në lidhje me çështjet e lirive dhe të drejtave të punonjësve si dhe harmonizimin efektiv të partneritetit social dypalësh dhe trepalësh, si dhe zhvillimin efektiv të dialogut social dhe dialogut civil.
- Shkëmbimin e rregullt të informacionit nëpërmjet organizimit të takimeve periodike, shkëmbimit të informacionit, vizitave të përbashkëta në terren, njoftimeve reciproke për raste të ndryshme që kanë nevojë për ndërhyrje dhe mbështetje.
- Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta ndërgjegjësuese në nivel kombëtar, përfshirë edhe organizimin e fushatave të përbashkëta për ndërgjegjësimin e publikut.

Avokati i Popullit

Igli Totozani



Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH)

President

Kol Nikollaj

